

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja Afërdita Bytyçi, më pjesëmarrjen e sekretares juridike Fahrije Beha, në çështjen penale kundër të akuzuarit K. V. nga P., për shkak të veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.501/2016, datë 14.10.2016, pas përfundimit të seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë më shenjën, PP/I.nr.501/2016, datë 12.10.2016, në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Kujtim Munishi, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, av. N. R., sipas autorizimit, më datë 09.11.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **K. V.**, më dok.id.- letërnjoftim nr. *numër personal...*, i biri i A. dhe A. e gjinisë Ç., i lindur më *data e lindjes....*, nga P., i martuar, ka të kryer fakultetin juridik, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Më datë 23.09.2016, rreth orës 11:30, në vendin e tij të punës në stacionin e autobusëve në Prishtinë, pa autorizim dhe në kundërshtim më ligjin e zbatueshëm lidhur më armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit dhe atë pistoletën më gaz, e tipit “Ekol Aras Magnum”, më nr.serik EA-1370623, një karikator dhe tre fishekë të prodhimit turk, të cilën më pas e ka dërguar në Tregun e Gjelbertë, në lagjen “Ulpiana” në Prishtinë, e që pas kontrollit nga pjesëtarët e policisë së Kosovës janë gjetur dhe sekuestruar dëshmitë e lartëcekura,-

-më këtë ka kryer veprën penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73 të KPRK-së, dhe nenit 360, 361 dhe 365 të KPPRK-së, e

GJYKON

Më dënim më gjobë në shumë prej 450 € (katërqind e pesëdhjetë euro), të cilin dënim është i obliguar që t'a paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi më gjobë nuk mund të realizohet në mënyrat dhe format e parapara më nenin 46 të KPRK-së, gjykata këtë dënim do t'a shndërrojë në dënim më burg duke llogaritur nga 1 (një) ditë burg për çdo 20 € të dënimit më gjobë.

DËNIM PLOTËSUES

Të akuzuarit konform nenit 69 të KPRK-së, i konfiskohet pistoleta më gaz, e tipit "Ekol Aras Magnum", më nr.serik EA-1370623, një karikator dhe tre fishekë të prodhimit turk.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhën sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.501/2016, datë 14.10.2016, ka akuzuar, K. V. nga P., për shkak të veprës penale, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së. Kjo prokurori se bashku me aktakuzën në gjykatë ka dorëzuar edhe Marrëveshjen për pranim të fajësisë me shenjën, PP/I.nr.501/2016, datë 12.10.2016, të lidhur në mes të prokurorit të shtetit, Kujtim Munishi, kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Imer Beka, të akuzuarit K. V. dhe mbrojtësit të tij, av. N. R., sipas autorizimit.

Kryetarja e trupit gjykues e kësaj Gjykate ka mbajtur seancën më datë 09.11.2016, ku kanë prezantuar prokurori i shtetit Kujtim Munishi, i akuzuari K. V. dhe mbrojtësi i tij, sipas autorizimit, av.N.R., ku palët pjesëmarrëse në negociata për lidhjen e marrëveshjes kanë mbetur në tërësi pranë marrëveshjes, ashtu sikur është prezantuar në formë të shkruar në gjykatë - përfshirë edhe lartësinë e dënimit të propozuar.

Gjykata ka vlerësuar se tani i akuzuari K. V., ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pas këshillimeve të mjaftueshme më mbrojtësin e tij, se pranimi i fajësisë mbeshtetet në faktet që i përmban

aktakuza dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë që përjashton përgjegjësinë ose ndjekjen penale.

Gjykata gjatë seancës vendosi që t'a pranoj marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe të akuzuarit K.V., i ka shqiptuar dënimin më gjobë në shumë prej 450 € (katërqind e pesëdhjetë euro), të cilën gjobë është i obliguar që t'a paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, duke marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese për tani të akuzuarin se ka pranuar fajësinë, më bindje se edhe më këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë më ligj.

Vendimi që i akuzuari të obligohet që t'i paguaj shpenzimet e procedurë penale dhe paushallit gjyqësor u mor konform nenit 453 të KPPRK-së, ndërsa lartësia e paushallit u caktua duke patur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale dhe gjendjen materiale të akuzuarit.

Më sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.581/16, datë 09.11.2016

Procesmbajtësja,
Fahrije Beha

Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Afërdita Bytyçi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa, Departamentit për Krime të Rënda në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.